



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Data: 30.09.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ F.V pjese kembimi per mjetet e bashkise Cerrik”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje të ndryshme transporti dhe pjesë këmbimi 34900000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 2583320 (*dy milion e peseqind e tetedhete e tre mije e treqind e njetete*)
LEKE pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të vënë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Referuar ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, sa vlera e përlllogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022,2023,2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022,2023,2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Per te provuar pervojen e meparshme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizime te ngjashme ne nje vlere jo me te ulet se 20% te fondit limit pa TVSH-, te realizuara (nga subjekti juaj) ne tri vitet e fundit financiar nga data shpalljes se njoftimit te kontrates..

Per kete rast te paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 OE duhet te paraqese nje deklarate per kryerjen e sherbimit te kerkuar nga autoriteti ne rast difekti ne kohen dhe vendodhjen e kerkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do duhet te kryejne sherbimin ne rast difekti ne kohen dhe ne vendodhjen e kerkuar .

2.3.3 OE duhet te paraqese nje deklarate qe mjetet me shpenzimet e tij me karrotrec do ti transportoje ne piken e servisit dhe anasjelltas ne rast difekti ne kohen dhe vendodhjen e kerkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar),

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të kete ne pronesi ose me qera nje servis makinash ne territorin e Bashkise Cerrik i cili vertetohet me kontrate qeraje ose certificate pronesie, ku te jete e shenuar me emertimin servis .

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar),

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat e kërkuara si me më poshte:

Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet në 1 (një) kampion/ mostër. Mostrat/ kampionet e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: “emri i artikullit”, “datën e zhvillimit të tenderit”, “emrin e prodhuesit/ofertuesit”, “nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik”. Mostrat mund të paraqiten deri në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Bashkise Cerrik, me adrese: Lagja nr.2 rruga “Gjimnazistet 1962”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6,a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.6.Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose,,**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar ne zbatim te nenit 36 te ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Specifikimet janë hartuar nga specialistet e fushes dhe gjenden bashkengjitur dokumentave standarte te tenderit.

Njesia e Prokurimit
